



72

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 625P/ Prot.

Datë 24.12. 2020

VENDIM

NR. 168 , DATË 24. 12. 2020

MBI

“MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË ELBASAN PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, pasi mori në shqyrtim materialet “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021”, të përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan nëpërmjet drejtorive të saj, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2021 për Bashkinë dhe institucionet vartëse të saj, në nivel programi, si më poshtë dhe sipas pasqyrave e materialeve bashkëlidhur :

1. Të ardhura gjithsej: 2,685,670 mijë lekë
2. Shpenzime gjithsej : 2,685,670 mijë lekë

2. Të miratojë kërkesat për projektet e investimeve për vitin 2021, me fondet e Zhvillimit të Rajoneve, sipas pasqyrës bashkëngjitur (tabela nr.9).

3. Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023, “Tavanet e shpenzimeve”, (tabela nr.2).

4/1. Në programin buxhetor afatmesëm, periudha viti 2022, artikulli 231, programi “Rrjeti rrugor rural”, është përfshirë shuma 156 milion lekë për “Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat të projektit “Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe rekreativiteti i blloqeve të banimit, në disa lagje të qytetit të Elbasanit”.

4/2. Të miratojë listën e investimeve në pritje, të cilat do të financohen në rast të gjetjes së burimeve financiare (tabela nr.10).

5. Kontributi i Bashkisë Elbasan për Këshillin e Qarkut për vitin 2021 është 1% mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

73

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja





1745
24.12.2020



(8)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE
ORGANIZATIVE

Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore
Sektori Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 6254 Prot.

Elbasan, më 24/12/2020

VENDIM

Nr. 16P datë 24/12/2020

"Mbi mirtimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2021".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2020, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore "Mbi mirtimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2021", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 pika "dh", ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenin 113 të ligjit 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5 të ligjit nr.10405 datë 24.03.2001 "Për kompetencat dhe përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve", VKM nr.177, datë 8.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165 datë 2.03.2016 të Këshillit të Ministrave 'Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësisve të vetëqeverisjes vendore", si dhe VKB 180, datë 04.12.2019 "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e pagave për vitin 2020"

VENDOSI :

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve vartëse të saj për vitin 2021 prej 1423 punonjësish, përfshirë numrin e punonjësve të funksioneve të deleguara dhe atyre specifike si (Sistemi Parauniversitar, Shërbimi Zjarrfikës, Gjendja Civile, dhe QKB), si dhe miratimin e tabelës së pagave për punonjësit e Bashkisë Elbasan për vitin 2021.

2 Numri i Punonjësve me kohë të pjesshme për vitin 2021 është si më poshtë:

- a) Qendra Kulturore e Fëmijëve 7 punonjës, 3 punonjës me 6 orë në javë dhe 4 punonjës me 4 orë në javë (350/lekë/orë);
- b) Agjencia e Shërbimeve Publike, 20 punonjës sezonal ujitje me pagë bazë 30 000 lekë për periudhën mars-dhjetor 2021;
- c) Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore dhe Mjedisore 5 vrojtues-sinjalizues zjarri për një kohëzgjatje prej 100 ditësh për person, me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi dhe 6 punonjës me kohë të pjesshme (5 punëtor me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi + 1 arkëtare me pagë sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur);
- d)) Qendra Ekonomike e Arsimit, 10 kaldaist me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi, si dhe 15 sanitare dhe 4 dezinfektues per nje periudhe 6 mujore nga momenti i lidhjes së kontratës. Pagat do të mbulohen nga fondi i pagave të parashikuara në Buxhetin e vitit 2021 për Qendrën Ekonomike të Arsimit.

3. Tabela e pagave të funksioneve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Elbasan, Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Vartëse për vitin 2021 të jetë sipas Lidhjes nr. 1-8 bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2021.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Financës, Administrata e Bashkisë dhe institucionet vartëse të saj.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas 10 ditësh nga shpallja.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETAR

Hektor Ciftja





7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6268/1 Prot.

Elbasan, më 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 140 Datë: 24.12.2020

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe reaktiviteti i blloqeve të banimit, në disa lagje të qytetit të Elbasanit”, Z.K. 8521, Z.K. 8523, Z.K. 8525, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .12 .2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Miraton në parim fillimin e procedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi i projektit me interes publik “Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe reaktiviteti i blloqeve të banimit , në disa lagje të qytetit të Elbasanit”, Z.K. 8521, Z.K. 8523, Z.K. 8525, ndodhur në Zonat Kadastrale të paraqitura në planimetritë bashkëlidhur.
2. Miraton burimin e financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi



KRYETARI
Hektor Ciftja





6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 62471 Prot.

Elbasan, më 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 171 Datë: 24.12.2020

“Mbi dhënie me qira dhe në përdorim (rinovim kontratash) të disa ambjenteve nga Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .12.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (Sektori i Pronave) “Mbi dhënie me qira dhe në përdorim (rinovim kontratash) të disa ambjenteve nga Bashkia Elbasan” dhe propozimin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja për rinovimin e kontratës së huapërdorjes konkretisht për Fondacionin “Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Vecanta”, me nje afat 5 (pesë) vjeçar, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; V.K.M Nr .416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”; V.K.M Nr. 81, datë 30.01.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bradashesh, të Qarkut të Elbasanit”, i ndryshuar; V.K.M nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; V.K.B Nr. 145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”;

V E N D O S I :

- 1.1 Miraton dhënien me qira të ambjentit (bodrum), në Pallatin Nr.15/1, Lagja “Kongresi Elbasanit”, me sipërfaqe 73.16 m², me tarifë qiraje mujore 200 lekë/m², për periudhën 1(një) vjeçare nga data **01.01.2021 deri më 31.12.2021**, subjektit qiramarrës **Zj. Edlira Serica** (për magazinë).
- 1.2 Miraton dhënien me qira të ambjentit (bodrum), në Pallatin Nr. 16, Lagja “Kongresi i Elbasanit”, me sipërfaqe 64.67 m², me tarifë qiraje mujore 200 lekë/m², për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2021 deri më 31.12.2021**, subjektit qiramarrës **Z. Admir Çerraga** (për magazinë).
- 1.3 Miraton dhënien me qira të ambjentit (dhomë farmaci), në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore, me sipërfaqe 39.02 m², me tarifë qiraje mujore 1000 lekë/m², për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2021 deri më 31.12.2021**, subjektit qiramarrës **Znj. Shpresa Topalli** (për farmaci).

1.4 Miraton dhënien me qira të ambjentit (bodrum) në pallatin Nr.494, lagja “Aqif Pasha”, me sipërfaqe 70 m², me tarifë qiraje 200 lekë/m², me afat 1 (një) vit nga data **01.01.2021 deri më 31.12.2021**, subjektit qiramarrës “**Embifarma**” (për magazinë).

1.5 Miraton dhënien në përdorim (pa pagesë) të ambjenteve me sipërfaqe totale 253.2 m², ndodhur në Shkollën e Muzikës “ONUFRI” (godina e ish mencës së konviktit), në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, Fondacionit “Aid To The Balkans”, për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2021 deri më 31.12.2021**, për të kryer aktivitete humanitare të përkujdesit komunitar të shtresave vulnerabël në Rajonin e Elbasanit.

1.6 Miraton dhënien në përdorim (pa pagesë) të ambjenteve me sipërfaqe me sipërfaqe trualli 734 m² dhe sipërfaqe ndërtese 399 m², në lagjen “Visarion Xhuvani”, Rr. “Rinia”, Nr. 6, Z.K. 8524, me nr. pasurie 6/82, Fondacionit “Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Vecanta”, për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data **16.02.2021 deri më 15.02.2026**, për të kryer aktivitete humanitare të përkujdesit komunitar në mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta për Rajonin e Elbasanit.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja





5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6256/ Prot.

Elbasan, më 24/12 / 2020

VENDIM

Nr. 172 datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NË QYTET, BASHKIA
ELBASAN"**

Këshilli Bashkiak , në mbledhjen e datës ___/___/ 2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin nr.115/2014 "Per ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores "Për funksionimin e strukturave komunitare në qytet", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Njësitë Administrative të Lagjeve të qytetit dhe Drejtoria e Koordinimit të këtyre njësive.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja



1727
24.12.2020



4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 62464 Prot.

Elbasan më, 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 173 Datë: 24.12.2020

“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve në banesë, si pasojë e përplasjes me armë zjarri, për Z. Spiro Leonidha Gugu, banor i Lagjes “11 Nëntori”, Pall. 576/1, Lagja Nr. 5, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga përplasjes me armë zjarri në banesën e shtetasit **Z. Spiro Leonidha Gugu**, banor i Lagjes “11 Nëntori”, Pall. 576/1, Lagja Nr.5, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga përplasjes me armë zjarri në banesën e shtetasit **Z. Spiro Leonidha Gugu**, e cila është në masën **19 700** (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **39 400 x 50% = 19 700 lekë**.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **19 700** (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë, për familjen e **Z. Spiro Leonidha Gugu**.
4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja



1729
24.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6246/Prot.
/2

Elbasan më, 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 177 Datë: 24.12.2020

“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën Z. Rakip Besim Bica, banor i fshatit Qafë, Njësia Administrative Labinot Mal, dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e tokës në banesës e **Z. Rakip Besim Bica**, banor i fshatit Qafë, Njësia Administrative Labinot Mal dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr.8756 datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

V E N D O S I :

- 1) Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
- 2) Të miratojë vlerën financiare, të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e tokës në banesës e **Z. Rakip Besim Bica**, në masën **826 554** (tetëqind e njëzet e gjashtëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) **lekë**, nga e cila qytetari përfiton **50%** të vlerës së preventivit të hartuar nga ekspertët, d.m.th. **1 653 109 x 50% = 826 554** lekë.
- 3) Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për **Z. Kujtim Sali Saliu**.
- 4) Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës prej **776 554** (shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) **lekë**, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlera

totale e dëmeve të konstatuara) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi, meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

- 5) Burimi i financimit, për pikën 3 të këtij vendimi, do të jetë Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
- 6) Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
- 7) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
- 8) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6257 Prot.

Elbasan më, 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 175 Datë: 24 . 12.2020

“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve në banesë, si pasojë e reshjeve dhe agjentëve atmosferik, për Z. Blerim Shyqyri Lamçja, banor i Lagjes “Çlirimi”, Rruga “Fetah Cankja”, Lagjia Nr. 2, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga erërat e forta në banesën e shtetasit **Z. Blerim Shyqyri Lamçja**, banor i Lagjes “Çlirimi”, Rruga “Fetah Cankja”, Lagjia Nr. 2, Elbasan si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga erërat e forta në banesën e shtetasit **Z. Blerim Shyqyri Lamçja**, e cila është në **42 658** (dyzet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **85 317 x 50% = 42 658** lekë.
3. Shuma në fjalë prej **42 658** (dyzet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, ti kalojë Agjencisë së Shërbimeve Publike Bashki nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019, për riparimin e dëmit në banesën e **Z. Blerim Shyqyri Lamçja**.

4. A.Sh.P. brënda 15 ditësh nga konfirmimi i V.K.Bashkiak duhet të riparojë dëmin e krijuar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, A.Sh.P. Bashki dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6246/3 Prot.

Elbasan më, 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 176 Datë: 24.12.2020

“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Musa Reshit Klllogjri, banor në Fshatin Hajdaran, Njësia Administrative Shushicë, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Musa Reshit Klllogjri**, banor në Fshatin Hajdaran, Njësia Administrative Shushicë si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogarit bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 432 519 x 50% = 716 259** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Musa Reshit Klllogjri** është në masën **716 259** (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **716 259** (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, për shtetasin **Z. Musa Reshit Klllogjri**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja





1726
24.12.2020



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6253/1 Prot.

Elbasan më, 24.12.2020

VENDIM

Nr. 177 datë 24.12.2020

***“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit,
zotit Altin Palloshi”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, zotit Altin Palloshi”*, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 *“Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”* (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. T'i japë titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, zotit Altin Palloshi, me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në fushën e kardiologjisë, duke treguar profesionalizëm, përkushtim dhe humanizëm në përballjen me sëmundjet kardiake, sidomos gjatë pandemisë shkaktuar nga COVID-19, duke krijuar për këtë qëllim edhe spitalin virtual “MilanoMedical”, në bashkëpunim me 40 mjekë shqiptarë, banues në Itali e jo vetëm”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja





1725
24.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 6245/prot

Elbasan me 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 173 / datë 24 / 12 / 2020

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës /12/2020 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.", neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror",

V E N D O S I

I. Të miratojë vendosjen e të moshuarit në Qendrën Sociale Balashe si më poshtë:

I moshuari Z. Sadik Rakip Biba , e datëlindjes 11.03.1948, banuese në Nj.Administrative Bradashesh, fshati Kusarth të Bashkisë Elbasan.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Qendres Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 6260/1 Prot

Elbasan, më 24.12.2020

VENDIM

NR. 179 DATË 24.12.2020

PËR

MIRATIM DHENIE BURSE SHTETI NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL
PËR VITIN SHKOLLOR 2020 - 2021

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____. ____ 2020 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit “ Mbi dhënien e bursës së shtetit nxënësve të shkollave të mesme të arsimit parauniversitar dhe profesional për vitin shkollor 2020-2021”, bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik”, për vitin shkollor 2020-2021”, me propozim të komisionit të dhënies së bursave të ngritur me urdhër të brendshëm nr.981 datë 14.12.2020 nga kryetari i bashkisë.

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e bursave nxënësve të shkollave të mesme të arsimit parauniversitar dhe profesional për vitin shkollor 2020-2021 sipas tabelave bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi për shkollat e mesme ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit dhe Qendra Ekonomike Arsimit, bashkia Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6243/13 Prot.

Elbasan, më 24.12.2020

V E N D I M

Nr. 180 datë 24.12.2020

***Për dhënien në përdorim me afat 9-vjeçar sipërfaqen pyjore prej 36.0 ha,
Për vendosje panelesh për prodhim energjie elektrike fotovoltaike dhe agropylltari,
në ngastrën nr. 27/a dhe 31/a të ekonomisë pyjore "Zalli Shkumbin."***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ____ .12.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit, i mbështetur në:

Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar), ligjin nr.57/2020 "Për pyjet", ligjin nr. 9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", (i ndryshuar), VKM nr. 391 datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", (i ndryshuar), VKM nr. 433 datë 8.6.2016 "Për transferimin, në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", (i ndryshuar), Udhëzimin e Ministrisë Mjedisit nr.1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik";

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien në përdorim të 36.0ha sipërfaqe pyjore publike, vendosje panelesh për prodhim energjie elektrike fotovoltaike dhe agropylltari, në ngastrën nr. 27/a dhe 31/a të ekonomisë pyjore "Zalli Shkumbin".
2. Afati i dhënies me qira të jetë 9 vjet.
3. Vlera fillestare e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr. 391 datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", (i ndryshuar).

4. Raporti "Mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqes 36.0ha, në pronësi të Bashkisë Elbasan, për vendosje panelesh, për prodhim energjie elektrike fotovoltaike dhe agropylltari, në ngastrën nr. 27/a dhe 31/a të ekonomisë pyjore "Zalli Shkumbin", është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi



KRYETARI

Hektor Çiftja

